



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P nr.641/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P. , gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurve S.U dhe E.C, sipas akuzës së PTH në Pejë PP/II.nr. 1045/14 të dt.07.7.20.16, për shkak të veprave penale të kryera secili veç e veç : të sulmit nga neni 187 par 1 të KPRK-së dhe veprave penale Lëndim I lehtë trupor nga neni 188 par 2 e lidhur me nën par 1.1 të KPRK-së dhe veprës penale: Asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 par 2 KPRK-së, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë e të pandehurve S. U dhe E. C dhe të prokurorit të shtetit Esad Muharemi me dt.15.3.2017 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

A K T G J Y K I M

Të pandehurit :

1 S.U i lindur me dt. Në Gj.tani me vendbanim në P rruga S.J , i biri i B dhe nënës Gj e gjinisë A , , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

2. E. C i lindur me dt. Në B.K.P , i biri i H dhe i nënës H e gjinisë Sh, , shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

JANË FAJTORË

Për shkak se :

I. I pandehuri S.U :

Me dt. 24.5.2014 , rreth orës 17:00, në fsh. F., me dashje e përdorë forcën ndaj të dëmtuarit E. C , në atë mënyrë që pas një zënke të çastit në mes të dëmtuarit dhe të pandehurit lidhur me një rrezikim të trafikut që sipas të pandehurit e kishte shkaktuar i dëmtuari , i pandehuri dele nga vetura e tij BMW , i afrohet kamionit të të dëmtuarit i cili ishte ndalur në rrugë , e kap këtë të fundit për dore duke e tërhequr e më pas e godet të njëjtin në pjesë të ndryshme të trupit .

-me çka ka kryer vepër penale : të sulmit nga neni 187 par 1 të KPRK-së .

II. I pandehuri E.C :

1.Me dt. 24.5.2014 , rreth orës 17:00, në fsh. F e P , me dashje me mjet të përshtatshëm për shkaktimin e lëndime të rëndë trupor , i shkaktonte lëndime trupore të dëmtuarit S. U. , në atë mënyrë që pas një zënke të çastit në mes të dëmtuarit dhe të pandehurit lidhur me një rrezikim të trafikut që sipas të dëmtuarit e kishte shkaktuar i pandehuri , ky i fundit pasi që sulmohet fizikisht nga i dëmtuari , i njëjti mbyllë me vrulle derën e kamionit e cila ishte hapur, me ç’ rast me derë ia zë dorën e djathtë të dëmtuarit ku si pasojë e kësaj ky i fundit pëson lëndime të lehta trupore.

-me çka ka kryer veprë penale : lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 2 lidhur me nën par 1.1 të KPRK-së .

2. Me dt. 24.5.2014 , rreth orës 17:00, në fsh. F e P , me dashje dëmton pasurinë , e të dëmtuarit S. U. në atë mënyrë që pasi i dëmtuari e kishte sulmuar fizikisht të pandehurin përderisa i njëjti ishte ulur në ulësen e kamionit , ky i fundit , meqenëse dera e kamionit ishte e hapur, e mbyll të njëjtën me vrull, duke ia zënë dorën , me ç’ rast të dëmtuarit ia dëmton orën e dorës e tipit “Rover Lakes” në vlerë prej 8.000 euro.

- me çka ka kryer veprës penale: Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par 2 të KPRK-së

Prandaj gjykata të pandehurve konform nenit 41, 85, 86 dhe nenit 187 par 1 , nenin 188 par 2 nën par 1.1, nenit 333 par 2 të KPRK-së U SHQIPTON

VËREJTJE GJYQËSORE

Në atë mënyrë që të :

Të pandehurve S. U dhe E. C :

U bëhet me dije se kanë kryer vepra të dëmshme dhe të rrezikshme që përbejnë veprë penale për të cilat nëse ata sërish i përsërisin gjykata do tu shqiptoi sanksion më të rëndë penal.

Obligohen të pandehurit që secili veç e veç në emër të paushallit gjyqësorë të paguajnë nga 15 euro -15 ditë pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë .

Shpenzime procedurale nuk ka pasur.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë me dt. 07.7.2016 kundër të pandehurve S. U. dhe E. C. ka ngritë aktakuzë dhe PP/II. nr.1045/14, për veprë penale të kryera secili veç e veç: të sulmit nga neni 187 par 1 dhe veprave penale : Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 2 e lidhur me nën par 1.1 të KPRK-së, dhe veprë penale Asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 par 2 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurit ti shpallë fajtorë, ti dënoj sipas ligjit dhe ti obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestar të pandehurit secili veç e veç – pasi që paraprakisht iu është lexuar aktakuza, janë njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasojat e pranimi përkatësisht të mos pranimi të fajësisë- e kanë pranuar fajësinë dhe kanë manifestuar keqardhje për atë që iu ka ndodhur. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit të shtetit ,e ka pranuar, i bindur se

pranim fajësinë të pandehurit e kanë bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë.

Meqenëse të pandehurit e kanë pranuar fajësinë gjyqtari kaloi në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese, me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur, kurse nga ato lehtësuese ka çmuar: pranimin e singertë të fajësisë nga ana e të pandehurve, pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë, e sidomos faktin se ata janë pajtuar dhe tani kanë raporte të mira në mes vete dhe kësaj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjyimit ndaj të pandehurve do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform neni 450

Nga sa u tha më lartë konform neni 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë.15.3.2017.

Sekretarja juridike
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari
Sejdi Blakaj

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë
E përmes kësaj Gjykate .